



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



# RAPORTI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE PËR VITIN 2023

Analizë studimi: Realizimi i zërave rregullatorë, të  
aprovuar për vitin 2023

Punuar nga DT/ ARRU  
Shtator 2023  
Prishtinë

## Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçiente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

## Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

## PËRMBAJTA

1	HYRJE .....	5
2	Qëllimi i raportit .....	6
3	KOMPONENTET e vlerësimit të caqeve.....	7
3.1	Lista e të dhënave që monitorohen për përmbushjen e caqeve .....	7
3.2	Shkallëzimi i përmbushjes së caqeve .....	8
3.3	Simboli dhe ngjyra e përmbushjes së caktuar .....	8
5.	analizë e prodhimit, faturimit dhe konsumatorëve .....	10
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, të humbur, të faturuar në m <sup>3</sup> dhe numrit të konsumatorëve.....	11
6.	analizë e shpenzimeve operative .....	14
6.1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura.....	14
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura .....	16
7.	ANALIZË E Faturimit dhe arkëtimit në vlerë financiare .....	17
7.1.	Analizë e vlerave financiare të faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura .....	18
7.2	Analiza grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura .....	19
7.3.	Analiza e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura .....	20
7.4.	Analiza grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura .....	21
8.	ANALIZA E INVESTIMEVE kapitale .....	22
8.1.	Analizë e Investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit .....	23
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale nga burimet vetjake të financimit .....	24
8.3.	Analizë e investimeve kapitale nga donatorët .....	25
8.4.	Analizë grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët .....	26
9.	Realizimi i përgjithshëm i caqeve .....	27
9.1.	Përmbushja e përgjithshme e caqeve sipas KRU-ve .....	28
9.	Konkluzione dhe rekomandime.....	33

---

## Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BRRR	Baza Rregullatore e Aseteve
DRP	Departamenti për raportim të performancës në ARRU
DT	Departamenti i Tarifave në ARRU
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Bifurkacioni” sh. a – Ferizaj
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Gjakova” sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Hidromorava” sh. a – Gjilan
GSJP	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetësit
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Hidrodrini” sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Prishtina” sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Hidroregjioni-Jugor” sh. a – Prizren
UPF	Uji i pa faturuar
UN	Ujëra të ndotura

# 1 HYRJE

---

Sipas praktikave të mira, të përvetësuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (tutje Autoriteti), kemi kënaqësinë t'iu prezantojmë Raportin e vitit 2023 mbi Vlerësimin e Shkallës së Përbushjes së Caqeve, të procesit rregullator tre vjeçar (2022-2024), për vitin 2023, i cili analizon parametra relevantë për analizën e përbushjes së caqeve të përcaktuara.

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, me të cilin vlerësohet shkalla e përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave për vitin 2023, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e referuar.

Raporti është punuar mbi bazën e tre të dhënave:

- I. Të dhënat e aprovuara nga ARRU gjatë procesit tarifor, për vitin 2023,
- II. Të dhënat e realizuara nga KRU-të për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2023, si dhe
- III. Të dhënat historike për të vitin 2022, për të vlerësuar trendin e zhvillimit të sektorit.

Raporti shqyrton të dhënat operative, financiare dhe të investimeve kapitale ku bëhet e mundur vlerësimi i përbushjes së caqeve të përcaktuara nga ARRU për vitin 2023.

Mbi bazën e përbushjes së caqeve të përcaktuara rregullatorë, Autoriteti ka bërë renditjen e ofruesve të shërbimeve .

Raporti, tregon se ka përmirësime në sektor tek caqet e caktuara, veçanërisht tek arkëtimi dhe faturimi, deridiku.

Raporti nuk e ka përfshirë indeksimin për normën e inflacionit.

Ky raport, është bazë e mirë vlerësimi, për përcaktimin e caqeve në procesin e ardhshëm tarifor.

## 2 QËLLIMI I RAPORTIT

---

Procesi tarifor që udhëheq ARRU, paraqet një tërësi komplekse të informatave të ndryshme të KRU-ve, përmes të cilave, jo vetëm që caktohen tarifat për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, por aty determinohen edhe një mori të dhënash operative, financiare dhe të investimeve kapitale që i arsyetojnë ato tarifa.

Prandaj, monitorimi i këtyre të dhënave të aprovuara nga Autoriteti, janë të një rëndësie të veçantë për të përcjellë afarizmin e KRU-ve për periudhën e analizuar kohore.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Vlerësimi i përmbushjes së caqeve krahasohet vetëm me të dhënat e aprovuara nga procesi tarifor, të cilat mbesin si të tilla gjatë viteve referuese të procesit, përveç të ndonjë rishqyrtimi të jashtëzakonshëm të tarifave.
- (ii) Të jepet informacion për shkallën e përmbushjes së caqeve operative dhe financiare të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale nga burimet vetjake të realizuara për periudhën kohore të vitit 2023.
- (iii) Rezultatet e këtij raporti, janë udhërrëfyes për Autoritetin dhe ofruesit e shërbimeve, se planifikimi duhet të bëhet në mënyrë profesionale, duke respektuar me përpikëri rregullativën ligjore në fuqi.
- (iv) Raporti mbështetet edhe në parimet e 'Kontabilitetit Rregullator' dhe metodat në këto udhëzime, si:
- (v) Llogaritë rregulluese - të dhënat historike që i raportohen Autoritetit, për t'i lejuar atij monitorimin e rezultateve të arritura kundrejt projeksioneve të përdorura, në kohën e caktimit të kontrollimit të çmimeve dhe të vlerësojë nivelin e performancës së ofruesit të shërbimeve në secilin prej aktiviteteve kyçe; dhe
- (vi) Projektionet - në veçanti, paraqitja e 'Biznes Planit Rregullator' (BPRR) tek Autoriteti, për qëllime të vlerësimit të kërkesave për shpenzimet në të ardhmen dhe përcaktimi i tarifave të duhura.

## 3 KOMPONENTET E VLERËSIMIT TË CAQEVE

### 3.1 Lista e të dhënave që monitorohen për përmbushjen e caqeve

Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, Autoriteti aprovoi një mori të dhënash, të cilat e përcaktojnë afarizmin e ofruesve të shërbimeve përgjatë periudhës së tarifimit. Në pamundësi për t'i vlerësuar përmbushjen e realizimit për të gjitha këto të dhëna, Autoriteti përmes këtij raporti merr për bazë vetëm 15 sosh, të cilat konsiderohen si të dhëna që mund të japin një pasqyrim të përgjithshëm dhe më objektiv të afarizmit të KRU-së.

Nr	Lista e të dhënave	Njësia	
1	Të dhënat teknike	Prodhimi i ujit	m <sup>3</sup>
2		Humbjet e ujit	m <sup>3</sup>
3		Faturimi i ujit (m <sup>3</sup> )	m <sup>3</sup>
4		Numri i konsumatorëve	Nr
5	Të dhënat financiare	Shpenzimet operative për ujë	€
6		Shpenzimet operative U.N	€
7		Faturimi për ujë (€)	€
8		Faturimi për U.N (€)	€
9		Arkëtimi për ujë (€)	€
10		Arkëtimi për U.N (€)	€
11	Të dhënat e investimeve kapitale vetjake	Investimet vetjake në resurse dhe trajtim të ujit	€
12		Investimet vetjake në distribuim të ujit	€
13		Investimet vetjake në aktivitetet biznesore për ujë	€
14		Investimet vetjake në grumbullimin e ujërave të ndotura	€
15		Investimet vetjake në aktivitete biznesore për ujëra të ndotura	€

Me anë të këtij raporti, Autoriteti, ofron të dhëna në vlera reale për secilin ofrues të shërbimeve, se cilat vlera dhe sasi janë aprovuar për vitin referues dhe pastaj paraqiten të dhënat e përmbushura për këtë periudhë kohore.

### 3.2 Shkallëzimi i përmbushjes së caqeve

Autoriteti e ka parashikuar mundësinë që ofruesit e shërbimeve, mund të kenë vështirësi në përmbushjen e caqeve në përpikëri, dhe si rrjedhojë e kësaj, ka shkallëzuar përmbushjen e cakut. Ky shkallëzim përbëhet prej katër kufijve, që bazohet në cakun e paraqitur si përqindje:

- Tejkallim Pozitiv ( > 102.00 %)
- Realizuar (98.01% - 102.00%)
- Përafruar (94.00% - 98.00 %)
- Jo realizuar (<94.00 % )

Ndërkaq, për disa të dhëna, vlerësimi pozitiv i përmbushjes së cakut, në aspektin matematikor të fjalës, është më i mirë nëse përqindja e realizimit të tyre është më e vogël se 100%. Kjo ka të bëjë kryesisht me të dhënat e ujit të **humbur në m<sup>3</sup>, shpenzimeve operative për ujë dhe shpenzimeve operative për ujëra të ndotura**. Për këtë, edhe metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së cakut, është pasqyrim i kundërt me kufijtë e paraqitur më lartë, dhe ky pasqyrim matematikisht shprehet kështu:

- Tejkallim Pozitiv ( <98 %)
- Realizuar (98.00% - 102.00%)
- Përafruar (102.01 % – 106.00%)
- Jo realizuar (>106.00 % )

### 3.3 Simboli dhe ngjyra e përmbushjes së cakut

Duke pasur parasysh se tabelat përmbajnë shumë të dhëna, dhe se lexuesi mund ta ketë të vështirë të orientohet shpejtë, shkallën e përmbushjes së cakut, Autoriteti e ka bërë përmes ngjyrës dhe simbolit përkatës. Simbolet dhe ngjyrat, prezantohen në tabelat vijuese.

Simboli dhe ngjyra përkatëse për të dhënat e humbjeve të ujit në m<sup>3</sup>, dhe të shpenzimeve operative.

Kufijtë	Përshkrimi	Simboli
< 98.00 %	Tejkallim Pozitiv	TP
98.00% - 102.00%	Realizuar	R
102.01%- 106.00%	Përafruar	P
> 106.00%	Jo Realizuar	JR
	Pakrahasueshëm	PK

Simboli dhe ngjyra përkatëse për të dhënat tjera.

<b>Kufijtë</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Simboli</b>
> 102.00 %	Tejkalim Pozitiv	TP
98.01% – 102.00%	Realizuar	R
94.00% – 98.00%	Përafruar	P
<94.00%	Jo Realizuar	JR
	Pa krahasuar	PK

## 5. ANALIZË E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËVE

Analiza vlerësuese, në vazhdim, ofron të dhëna për këto kategori operative: uji të prodhuar, të faturuar, të humbur si dhe numrit të konsumatorëve. Autoriteti bëri krahasimin e të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me ato të aprovuara.


Tabela Nr. 1. Krahasimi i të dhënave të aprovuara të vitit 2023 me të dhënat e realizuara të vitit 2023 dhe të dhënat historike për periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Emri i KRU	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	56,055,696	53,331,757	57,266,265	107.38%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	31,897,094	27,144,201	32,469,094	119.62%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	24,158,602	26,187,556	24,797,171	94.69%	P
	Konsumatorët	Nr	159,130	169,587	171,180	100.94%	R
PZ	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	16,850,892	18,463,049	27,453,728	148.70%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	9,046,730	8,863,635	19,382,589	218.68%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	7,804,162	9,599,415	8,071,139	84.08%	JR
	Konsumatorët	Nr	56,525	61,097	58,963	96.51%	P
PE	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	24,853,142	23,726,876	38,641,481	162.86%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	14,822,864	12,900,000	28,688,407	222.39%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	10,030,278	10,826,876	9,953,074	91.93%	JR
	Konsumatorët	Nr	55,150	55,644	57,118	102.65%	TR
MIT	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	27,298,408	24,512,885	27,527,413	112.30%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	14,456,379	11,412,885	14,854,005	130.15%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	12,842,029	13,100,000	12,673,408	96.74%	P
	Faturimi-Jug	m <sup>3</sup>	8,231,877	8,300,000	7,787,634	93.83%	JR
	Faturimi-Veri	m <sup>3</sup>	4,610,152	4,800,000	4,885,774	101.79%	R
	Konsumatorët	Nr	47,679	43,464	49,696	114.34%	TR
GJA	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	16,177,553	15,595,903	15,726,213	100.84%	R
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	7,761,718	5,643,674	7,514,740	133.15%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	8,415,835	9,952,229	8,211,473	82.51%	JR
	Konsumatorët	Nr	45,807	47,534	47,724	100.40%	R
FE	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	8,104,348	9,878,279	8,182,764	82.84%	JR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	4,128,167	5,495,400	3,793,223	69.03%	TR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	3,976,181	4,382,879	4,389,541	100.15%	R
	Konsumatorët	Nr	36,418	38,226	40,196	105.15%	TR
GJI	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	7,495,340	7,854,741	8,616,001	109.69%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	3,494,250	3,232,781	4,479,643	138.57%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	4,001,090	4,621,960	4,136,358	89.49%	JR
	Konsumatorët	Nr	35,912	39,071	37,910	97.03%	P
SEKTORI	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	156,835,379	153,363,491	183,413,86	119.59%	TR
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	85,607,202	74,692,578	111,181,70	148.85%	JR
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	71,228,177	78,670,913	72,232,164	91.82%	JR
	Konsumatorët	Nr	436,621	454,623	462,787	101.80%	R


## 5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, të humbur, të faturuar në m<sup>3</sup> dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikëve, të cilët mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike për vitin 2022, me të dhënat e aprovuara nga Autoriteti dhe të dhënat e realizuara nga ofruesi i shërbimeve për vitin 2023.


### Uji i prodhuar në m<sup>3</sup>




### Uji i humbur në m<sup>3</sup>



## Uji i faturuar në m<sup>3</sup>



## Konsumatorët



Nga tabela numër 1 vërejmë se në bazë sektori, prodhimi në total ka tejkaluar sasinë e prodhimit të aprovuar nga Autoriteti, për 19.59 %.

Në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sektori ka shënuar rritje të prodhimit, krahasuar me vitin paraprak.

Tejkalimin më të madh të cakut në prodhimin e ujit nga të gjitha kompanitë (shprehur në %-je) e ka arritur KRU “Mitrovica”, e cila ka tejkaluar cakun e aprovuar nga ARRU për 12.3 %.

Në nivel sektori, uji i humbur, rezulton si tregues alarmues, sepse sektori shënoi humbje uji për 111,181,701.00 m<sup>3</sup>. Të dhënat e realizuara nga ofruesit e shërbimeve për humbjet e ujit, kur krahasohen me të dhënat e aprovuara nga Autoriteti për vitin 2022, rezulton se humbjet e realizuara janë për 32.82 % më shumë sesa ato që ka aprovuar Rregullatori. Kjo është njëra nga sfidat më të mëdha për sektorin dhe Autoritetin, veçanërisht mos adresimi i humbjeve të ujit është alarmant dhe se kjo zgjidhje kërkon analiza shtesë nga kompanitë- ofruese të shërbimeve aksionari dhe Autoriteti. Një ndihmesë e madhe do të ishte vendosja e ujëmatësve digjital tek çdo njësi prodhimi dhe mandej vendosja e matësve zonal, kalibrimi i gjithë këtyre, aplikimi i zbuluesve të rrjedhjeve dhe kontrollet e shtuara në terren.

*Faturimi* është njëri nga indikatorët e rëndësishëm matës të përmbushjes së caktit. Sektori ka arritur që ta faturojë 1.41 % më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, por sektori ka dështuar në arritjen e caktit për 8.18 %.

## 6. ANALIZË E SHPENZIMEVE OPERATIVE

---

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura janë kategorizuar komfor udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura.

*Shpenzimet direkte operative* lidhur me ofrimin e shërbimeve përfshijnë: fuqinë punëtore të angazhuar; energjinë elektrike; kemikaljet; materiet konsumuese; shpenzimet e përbashkëta; taksat e pa-rimbursueshme dhe shpenzimet tjera.

Sipas UKRR, shpenzimet operative ndahen në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të ndotura, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme, se cilët zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU ([www.arru-rks.org](http://www.arru-rks.org)).

### 6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura


Përmes tabelorit në vijim janë të shfaqura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura për secilin ofrues të shërbimeve dhe sektorin si tërësi, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike për vitin 2022, ato të aprovuara nga Autoriteti si dhe ato të realizuara nga ofruesit e shërbimeve gjatë vitit 2023, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura në €


Emri i KRU	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Ujë	€	9,350,804	10,604,959	9,552,333	90.07%	TP
	Ujëra të Ndotura	€	1,432,049	1,144,072	2,162,593	189.03	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>10,782,853</b>	<b>11,749,032</b>	<b>11,714,926</b>	<b>99.71%</b>	R
PZ	Ujë	€	3,152,367	3,604,335	3,560,473	98.78%	R
	Ujëra të Ndotura	€	932,389	1,121,220	1,084,431	96.72%	TP
	<b>Totali</b>	€	<b>4,084,756</b>	<b>4,725,555</b>	<b>4,644,904</b>	<b>98.29%</b>	R
PE	Ujë	€	2,708,547	2,456,600	2,569,005	104.58	P
	Ujëra të Ndotura	€	395,927	854,320	908,457	106.34	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>3,104,474</b>	<b>3,310,920</b>	<b>3,477,462</b>	<b>105.03</b>	P
MIT	Ujë	€	3,294,011	3,484,545	3,657,988	104.98	P
	Ujëra të Ndotura	€	341,491	322,320	380,940	118.19	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>3,635,502</b>	<b>3,806,865</b>	<b>4,038,928</b>	<b>106.10</b>	JR
GJA	Ujë	€	3,541,041	3,492,499	3,409,599	97.63%	TP
	Ujëra të Ndotura	€	360,754	759,163	414,510	54.60%	TP
	<b>Totali</b>	€	<b>3,901,795</b>	<b>4,251,662</b>	<b>3,824,109</b>	<b>89.94%</b>	TP
FE	Ujë	€	1,337,460	1,669,721	1,789,064	107.15	JR
	Ujëra të Ndotura	€	242,088	289,105	357,284	123.58	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>1,579,548</b>	<b>1,958,826</b>	<b>2,146,348</b>	<b>109.57</b>	JR
GJI	Ujë	€	1,634,512	1,696,078	1,903,626	112.24	JR
	Ujëra të Ndotura	€	150,497	176,109	174,495	99.08%	R
	<b>Totali</b>	€	<b>1,785,009</b>	<b>1,872,187</b>	<b>2,078,121</b>	<b>111.00</b>	JR
Sektori	Ujë	€	25,018,742	27,008,737	26,442,088	97.90%	TP
	Ujëra të Ndotura	€	3,855,195	4,666,309	5,482,710	117.50	JR
<b>Totali i përgjithshëm</b>		€	<b>28,873,937</b>	<b>31,675,047</b>	<b>31,924,798</b>	<b>100.79</b>	R

## 6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura


### Shpenzimet operative për ujë



### Shpenzimet operative për ujëra të ndotura



### Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative nga KRU-të



## 7. ANALIZË E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË VLERË FINANCIARE

---

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë financiare janë paraqitur në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secili ofrues i shërbimeve, në veçanti, dhe sektorit në përgjithësi. Në analizë, hynë të dhënat historike të realizuara për të vitit 2022, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2023, sipas procesit tarifor tre vjeçar (2022-2024). Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; ndaras për shërbimet e ujit dhe ndaras për shërbimet e ujërave të ndotura dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo ofrues shërbimi veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar të vitit 2023 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të së njëjtës periudhë të këtij viti, me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2022.

Sipas politikave tarifore, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për ujëra të ndotura i atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të ndotura.

Fatkeqësisht, jo të gjithë ofruesit e shërbimeve kanë qenë në gjendje që ta bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe për ujëra të ndotura, Autoriteti që i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas vlerësimit të tij, përmes metodave anësore të vlerësimit. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga Autoriteti-ofruesi i shërbimeve dhe ato të realizuara nga ky i fundit dhe sektorit të cilit i takojnë.

Kompanitë duhet që ta dizajnojnë softuerin financiar për t'i ndarë arkëtimet e sipër referuara, e cila gjë nuk kërkon kosto shtesë dhe lehtëson edhe raportimet menaxheriale, të vlefshme për vendimmarrje. Ka ofrues me softuer të sofistikuar dhe prapë nuk e bëjnë ndarjen përmes kontimit në kontabilitetin financiar.

### *Shënim:*

*Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i saj çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.*

## 7.1. Analizë e vlerave financiare të faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare, për të dhënat historike të vitit 2022, ato të aprovuara nga Autoriteti dhe të realizuara nga ofruesit e shërbimeve dhe sektori për të vitit 2023.


Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare

Emri i KRU	Të dhënat e faturimit	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Ujë	€	13,939,314	14,959,850	14,019,707	93.72%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	1,760,096	1,793,040	1,771,593	98.80%	R
	<b>Totali</b>	€	<b>15,699,410</b>	<b>16,752,890</b>	<b>15,791,300</b>	94.26%	P
PZ	Ujë	€	3,924,934	4,669,478	4,381,919	93.84%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	1,306,207	1,437,355	1,381,159	96.09%	P
	<b>Totali</b>	€	<b>5,231,141</b>	<b>6,106,833</b>	<b>5,763,078</b>	94.37%	P
PE	Ujë	€	3,336,180	3,714,437	3,414,920	91.94%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	893,544	1,039,561	951,843	91.56%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>4,229,724</b>	<b>4,753,998</b>	<b>4,366,763</b>	91.85%	JR
MIT	Ujë-Jugu	€	3,726,858	3,780,411	3,592,873	95.04%	P
	Ujë-Veriu	€	783,726	816,096	830,582	101.77	R
	Ujëra të Ndotura	€	661,229	643,885	576,890	89.60%	JR
	<b>Totali<sup>1</sup></b>	€	<b>4,388,087</b>	<b>4,424,296</b>	<b>4,169,763</b>	94.25%	P
GJA	Ujë	€	3,986,353	4,772,622	3,802,407	79.67%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	889,713	1,103,194	904,834	82.02%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>4,876,066</b>	<b>5,875,816</b>	<b>4,707,241</b>	80.11%	JR
FE	Ujë	€	1,975,991	2,204,247	2,214,294	100.46	R
	Ujëra të Ndotura	€	434,590	428,444	484,209	113.02	P
	<b>Totali</b>	€	<b>2,410,581</b>	<b>2,632,691</b>	<b>2,698,503</b>	102.50	P
GJI	Ujë	€	1,957,050	2,234,101	2,022,289	90.52%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	324,887	354,653	335,517	94.60%	P
	<b>Totali</b>	€	<b>2,281,937</b>	<b>2,588,753</b>	<b>2,357,806</b>	91.08%	JR
Sektori	Ujë	€	32,846,680	36,335,146	33,448,409	92.06%	JR
	Ujëra të Ndotura	€	6,270,266	6,800,131	6,406,045	94.20%	P
<b>Totali i sektorit</b>		€	<b>39,116,946</b>	<b>43,135,277</b>	<b>39,854,454</b>	<b>92.39%</b>	JR


<sup>1</sup> Për vlerësimin e përbushjes së caktuar të KRU "Mitrovica", totali nuk përmban sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturuar në atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

## 7.2 Analiza grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura


### Faturimi për ujë në euro



### Faturimi për ujëra të zeza në euro



### Përqindja e realizimit të faturimit në Euro



### 7.3. Analiza e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare, për të dhënat historike të vitit 2022, ato të aprovuara nga Autoriteti dhe të realizuara nga ofruesit e shërbimeve për vitin 2023.


Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare

Emri i KRU	Arkëtimi për shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Ujë	€	12,596,611	14,084,575	14,760,174	104.80%	IR
	Ujëra të Ndotura	€	1,590,555	1,703,956	1,865,162	109.46%	IR
	<b>Totali</b>	€	<b>14,187,166</b>	<b>15,788,531</b>	<b>16,625,336</b>	105.30%	IR
PZ	Ujë	€	3,835,227	4,365,484	4,163,215	95.37%	P
	Ujëra të Ndotura	€	1,276,353	1,352,696	1,312,225	97.01%	P
	<b>Totali</b>	€	<b>5,111,580</b>	<b>5,718,180</b>	<b>5,475,440</b>	95.75%	P
PE	Ujë	€	2,975,511	3,497,563	2,876,058	82.23%	IR
	Ujëra të Ndotura	€	796,944	993,627	801,646	80.68%	IR
	<b>Totali</b>	€	<b>3,772,455</b>	<b>4,491,190</b>	<b>3,677,704</b>	81.89%	IR
MIT	Ujë	€	2,907,282	3,273,003	3,788,744	115.76%	IR
	Subvencionet	€	340,000	816,096	0	!	PK
	Ujërat e ndotura	€	515,818	572,363	608,340	106.29%	IR
	<b>Totali<sup>2</sup></b>	€	<b>3,423,100</b>	<b>3,845,366</b>	<b>4,397,084</b>	114.35%	IR
GJA	Ujë	€	4,132,914	4,511,361	3,938,619	87.30%	IR
	Ujëra të Ndotura	€		1,048,961	937,247	89.35%	IR
	<b>Totali</b>	€	<b>4,132,914</b>	<b>5,560,322</b>	<b>4,875,866</b>	87.69%	IR
FE	Ujë	€	1,893,346	2,056,421	2,339,740	113.78%	IR
	Ujëra të Ndotura	€	416,414	401,662	511,641	127.38%	IR
	<b>Totali</b>	€	<b>2,309,760</b>	<b>2,458,084</b>	<b>2,851,381</b>	116.00%	IR
GJI	Ujë	€	1,968,177	2,090,024	2,232,565	106.82%	IR
	Ujëra të Ndotura	€	326,734	333,588	370,404	111.04%	IR
	<b>Totali</b>	€	<b>2,294,911</b>	<b>2,423,612</b>	<b>2,602,969</b>	107.40%	IR
Sektorit	Ujë	€	30,309,069	33,878,431	34,099,116	100.65%	R
	Ujëra të Ndotura	€	4,922,817	6,406,854	6,406,664	100.00%	R
<b>Totali i sektorit</b>		€	<b>35,231,886</b>	<b>40,285,285</b>	<b>40,505,780</b>	100.55%	R


<sup>2</sup> Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet operative të KRU "Mitropvica", nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

## 7.4. Analiza grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura


### Arkëtimi për ujë në euro



### Arkëtimi për ujëra të zeza në euro



### Përqindja e realizimit të arkëtimit në Euro



## 8. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

---

Me aprovimin e tarifave për periudhën tre vjeçare 2022-2024, Autoriteti dhe ofruesi i shërbimeve, kanë planifikuar realizimin e vlerave të caktuara financiare të investimeve. Këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, të cilat pas realizimit mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura**.

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura:

- Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Investimet në asetet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asetet nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve mandej kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime, shfrytëzuesit e raportit mund të gjejnë shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

## 8.1. Analizë e Investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit


Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet e kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit të vitit 2023. Me këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të për vitin 2023, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

*Tabela Nr. 7. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet e vetëfinancimit të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për 2023.*


KRU	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuar a KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Ujë	€	525,526	1,275,600	701,477	54.99%	JR
	Ujëra të ndotura	€	191,505	228,000	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	<b>717,031</b>	<b>1,503,600</b>	<b>701,477</b>	<b>46.65%</b>	JR
PZ	Ujë	€	594,062	653,500	493,986	75.59%	JR
	Ujëra të ndotura	€	6,360	197,000	1,321	0.67%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>600,422</b>	<b>850,500</b>	<b>495,307</b>	<b>58.24%</b>	JR
PE	Ujë	€	381,219	866,400	409,283	47.24%	JR
	Ujëra të ndotura	€	13,494	50,000	112,348	224.70%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>394,713</b>	<b>916,400</b>	<b>521,631</b>	<b>56.92%</b>	JR
MIT	Ujë	€	5,246	390,000	79,147	20.29%	JR
	Ujëra të ndotura	€	119	150,000	4,710	3.14%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>5,365</b>	<b>540,000</b>	<b>83,857</b>	<b>15.53%</b>	JR
GJA	Ujë	€	600,850	978,932	915,233	93.49%	JR
	Ujëra të ndotura	€	2,806	207,900	15,264	7.34%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>603,656</b>	<b>1,186,832</b>	<b>930,497</b>	<b>78.40%</b>	JR
FE	Ujë	€	83,256	311,990	118,601	38.01%	JR
	Ujëra të ndotura	€	14,461	130,000	16,178	12.44%	JR
	<b>Totali</b>	€	<b>97,717</b>	<b>441,990</b>	<b>134,779</b>	<b>30.49%</b>	JR
GJI	Ujë	€	133,123	335,530	170,908	50.94%	JR
	Ujëra të ndotura	€	8,797	116,112	109,669	94.45%	P
	<b>Totali</b>	€	<b>141,920</b>	<b>451,642</b>	<b>280,577</b>	<b>62.12%</b>	JR
SEKTORI	Ujë	€	2,323,282	4,811,952	2,888,635	60.03%	JR
	Ujëra të ndotura	€	237,542	1,079,012	259,490	24.05%	JR
<b>Totali i sektorit</b>		€	<b>2,560,824</b>	<b>5,890,964</b>	<b>3,148,125</b>	<b>53.44%</b>	JR

## 8.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale nga burimet vetjake të financimit


### Investimet vetanake për ujë



### Investimet vetanake për ujëra të zeza



### Përqindja e realizimit të investimeve vetanake në €



### 8.3. Analizë e investimeve kapitale nga donatorët


Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e vlerave financiare të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve, të cilët kanë qenë pjesë e planifikimit të projekteve për investime kapitale (për shërbimet e ujit) në vitin 2023. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përbushjes së objektivave, të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat shprehen në % me vlerësimin përfundimtar.

Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për vitin 2023.


Emri i KRU	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 2022	Aprovuara 2023	Realizuara KRU 2023	% Real. cak	Vlerësimi për 2023
PR	Ujë	€	147,266	0	115,197	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	510,405	54,150,000	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	657,671	<b>54,150,000</b>	<b>115,197</b>	<b>0.21%</b>	JR
PZ	Ujë	€	136,918	11,648,000	324,400	2.79%	JR
	Ujëra të ndotura	€	43,713	8,447,000	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	180,631	<b>20,095,000</b>	<b>324,400</b>	<b>1.61%</b>	JR
PE	Ujë	€	0	0	0	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	0	2,290,016	!	PK
	<b>Totali</b>	€	0	<b>0</b>	<b>2,290,016</b>	!	PK
MIT	Ujë	€	410	0	1,916,121	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	41	0	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	451	<b>0</b>	<b>1,916,121</b>	!	PK
GJA	Ujë	€	104,996	0	446,653	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	23	0	15,366,066	!	PK
	<b>Totali</b>	€	105,019	<b>0</b>	<b>15,812,719</b>	!	PK
FE	Ujë	€	360	0	1,707,022	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	90	0	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	450	<b>0</b>	<b>1,707,022</b>	!	PK
GJI	Ujë	€	76,847	3,600,000	843,376	23.43%	JR
	Ujëra të ndotura	€	0	0	0	!	PK
	<b>Totali</b>	€	76,847	<b>3,600,000</b>	<b>843,376</b>	<b>23.43%</b>	JR
Sektori	<b>Ujë</b>	€	466,797	15,248,000	5,352,769	35.10%	JR
	<b>Ujëra të ndotura</b>	€	554,272	62,597,000	17,656,082	28.21%	JR
<b>Totali i sektorit</b>		€	1,021,069	<b>77,845,000</b>	<b>23,008,851</b>	<b>29.56%</b>	JR

## 8.4. Analizë grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët


### Investimet nga donacionet për ujë



### Investimet nga donacionet për ujëra të zeza



### Përqindja e realizimit të investimeve nga donatorët në €



## 9. REALIZIMI I PËRGJITHSHËM I CAQEVE

Nga raporti i përmbushjes së caqeve të cilin e punon DT/ARRU vërehet se për secilën KRU është caktuar një cak përkatës përmes së cilit monitorohet shkalla e përmbushjes së tyre. Në këtë raport janë paraqitur një mori të dhënash të përcaktuara si cak, dhe secila prej tyre e ka rëndësinë e vet e cila mundëson KRU-se të ofrojë shërbime me nivel të kënaqshëm të ujësjellësit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura. Mirëpo nëse duam të kemi një pasqyrë të përgjithshme se cila prej KRU-ve ka arritur më së miri t'u afrohet përmbushjes së caqeve në krahasim me KRU-të tjera, DT/ARRU do të paraqes një metodologji të rangimit të cilën e konsideron si më të arsyeshmen në rrethanat të cila gjendet sektori i ujit në Kosovë.

Kjo metodologji e vlerësimit të përgjithshëm të KRU-ve konsiston në të dhënat e paraqitura në raportin e përmbushjes së caqeve, ku për secilën të dhenë është dhenë pesha e tyre për vlerësim, ashtu siç është paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela Nr. 11. Metodologjia e rangimit të KRU-ve

Grupi i të dhënave	Të dhënat	Pesha e të dhënës për vlerësim
Të dhënat teknike	Prodhimi i Ujit	9.09 %
	Humbjet e Ujit	9.09 %
	Faturimi i ujit (m3)	9.09 %
Te dhënat financiare	Shpenzimet operative për ujë	9.09 %
	Shpenzimet operative U.N	9.09 %
	Faturimi për ujë (€)	9.09 %
	Faturimi për U.N (€)	9.09 %
	Arkëtimi për ujë (€)	9.09 %
	Arkëtimi për U.N (€)	9.09 %
Investimet vetanake	Ujësjellës	9.09 %
	Ujëra të ndotura	9.09 %
Performanca e përgjithshme		100 %

Përqindja e realizimit të caktuar shumëzohet me peshën e të dhënës për vlerësim dhe kështu përfitohet rezultati i realizimit të caktuar për një të dhënë. Në këtë mënyrë, për të gjitha të dhënat aplikohet kjo metodologji, dhe në fund përfitohet rezultati i përgjithshëm i realizimit të të gjitha caqeve.

Si shembull marrim të dhënë e realizimit të caktuar për investimet kapitale të ujësjellësit, nëse një KRU ka realizuar këtë cak për 50%, atëherë kalkulimet duken kështu:

$$\text{Poentimi} = 50\% * 9.09\% = 4,545\%$$

Pra, si pasojë e realizimit të gjysmës së investimeve, një KRU ka marrë 4.545% të poenëve, e cila është gjysma e totalit të kësaj të dhëne prej 9.09%. në mënyrë analoge për të gjitha të dhënat tjera aplikohet kjo metodologji.

Grafikisht kjo metodologji më së miri do të paraqitet përmes diagramit vijues, i cili njëkohësisht paraqet të gjitha të dhënat e përcaktuara si cak nga ARRU. Kjo nënkupton se një kompani do duhej që sa më shumë të jetë e mundshme të arrijë të mbush hapësirën përbrenda kësaj zone të caqeve. Prandaj dhe mund të themi se kompania e cila ka arritur të ketë sipërfaqe më të madhe brenda zonës së caqeve, do të jetë njëra ndër kompanitë që ka arritur më së shumti të përmbush caqet e përcaktuar nga ARRU.

## 9.1. Përmbushja e përgjithshme e caqeve sipas KRU-ve

Në këtë pjesë do të shfaqen në mënyrë të listuar përmes tabelës, si dhe individualisht sipas grafikoneve, realizimi i caqeve të përcaktuara nga ARRU për vitin 2023.

Përmes grafi koneve mund të vërehet se caqet që janë përmbushur më pak, dhe i cili ka ndikuar tek KRU-të të të mos realizojnë mirë përmbushjen e tyre, janë:


- Humbjet e ujit në m<sup>3</sup>,
- Prodhimi i ujit, dhe
- Investimet kapitale, me theks të veçantë atë në shërbimet e ujërave të ndotura.

KRU-të duhet të angazhohen më shumë që të punojnë në menaxhimin e duhur të humbjeve të ujit, si dhe bashkë me të edhe në sasinë e ujit të prodhuar. Të dyja këto bashkë janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, dhe mos planifikimi i duhur, e bashkë me të, edhe mos realizimi i duhur, shkakton, fillimisht, në uljen e nivelit të shërbimit, e pastaj edhe në përqindjen e vogël të realizimit të përgjithshëm të caqeve. Kjo vërehet sidomos tek KRU-të Prishtina dhe Hidroregjioni-Jugor, të cilat për shkak të planifikimeve jo të duhura dhe realizimit jo të duhur janë listuar të fundit për nga përmbushja e përgjithshme e caqeve. Rasti i KRU "Prishtina" ka ndikuar edhe kategorizimi jo i duhur i shpenzimeve operative, në mes të shërbimeve të ujit dhe të atyre të ujërave të ndotura.


Tabela nr. 12. Përmbushja e përgjithshme e caqeve

KRU	Përmbushja e përgjithshme e cakt
KRU "HIDROMORAVA" SH.A - GJILAN	88.10%
KRU "BIFURKACIONI" SH.A - FERIZAJ	82.04%
KRU "GJAKOVA" SH.A - GJAKOVË	80.77%
KRU "HIDRODRINI" SH.A - PEJË	79.51%
KRU "MITROVICA" SH.A - MITROVICË	77.40%
KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN	76.60%
KRU "PRISHTINA" SH.A - PRISHTINË	75.77%


## PRISHTINA (75.7%)




## H-JUGOR (76.6%)




## HIDRODRINI (79.5%)




## MITROVICA (77.4%)



## GJAKOVA (80.7%)




## BIFURKACIONI (82.0%)



# HIDROMORAVA (88.1%)

■ Kompania Ideale

■ % e realizimit te caqeve



## 9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

---

1. Raporti shqyrton të dhënat operative, financiare dhe investimet kapitale, ku bëhet i mundur vlerësimi i përmbushjes së caqeve të përcaktuara nga ARRU për vitin 2023.
2. Vlerësimi i përmbushjes së caqeve krahasohet vetëm me të dhënat e aprovuara nga procesi tarifor
3. Në sektor, prodhimi i realizuar është më i lartë se sa ai që ka aprovuar ARRU, ku shënohet një tejkalim i prej 19.59 %.
4. KRU “Bifurkacioni” është ofruesi i vetëm që ka prodhuar nën planifikimin rregullator.
5. Faturimi është njëri nga indikatorët e rëndësishëm matës të përmbushjes së caktut. Sektori ka arritur që ta faturojë 1.41 % më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, por sektori nuk arriti cakun për 8.18 %. Autoriteti ka planifikuar 78,670,913.00 m<sup>3</sup> ujë të faturuar, kurse sektori ka faturuar vetëm 72,232,164.00 m<sup>3</sup>, ose 91.82 % realizim i BPRR-së.
6. Në nivel sektori, uji i humbur, rezulton si tregues alarmues, sepse sektori shënoi humbje uji për 111,181,701.00 m<sup>3</sup>. Të dhënat e realizuara nga ofruesit e shërbimeve për humbjet e ujit, kur krahasohen me të dhënat e aprovuara nga Autoriteti për vitin 2023, rezulton se humbjet e realizuara janë për 32.82 % më shumë sesa ato që ka aprovuar Rregullatori. Kjo kërkon edhe më shumë analiza dhe gjetje mundësish për përmirësim të situatës në terren.
7. Për vitin 2023, rezulton se humbjet e realizuara janë për 48.85 % më shumë, sesa ato që ka njohur Autoriteti.
8. Numri i konsumatorëve, në nivel sektor,i është tejkaluar për 1.8 %. Vetëm KRU “ Hidromorava’ dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” kanë pasur në vitin 2023 më pak konsumatorë nga planifikimet e Autoritetit.
9. Shpenzimet operuese për ujë, në nivel sektori, janë realizuar, për 97.9 %, kurse për ujëra të ndotura 117.5 %. Inkurajuese është fakti se KRU “Gjakova” ka realizuar vetëm 89.9 % të shpenzimeve të miratuara operuese, kurse KRU “ Hidroregjioni Jugor”-98.3 %, dhe KRU “Prishtina”- 99.7 %. Shpenzimet operuese nga planifikimet e Autoritetit, tejkalimin më të lartë e patën: KRU “Hidromorava”-11 %; KRU “Mitrovica”- 106.1 % dhe KRU “Hidrodrini”- 105 %.
10. Është mbresëlënëse, se caku për arkëtime në nivel sektori është përmbushur, duke qenë kështu, një indikacion se edhe në zërat tjerë, sektori me përkushtim shtesë, do t’ia del. Arkëtimi në nivel sektori, për ujë plani është realizuar 100.65 %, kurse për ujëra të ndotura, 100.0 %. KRU “ Bifurkacioni” ka arritur shkallën më të lartë të arkëtimit - 116.0 %, KRU ‘ Mitrovica”- 114.3 %, KRU “Gjakova”- 107.4 %, KRU “Prishtina”- 105.3 %, pasojnë: KRU” Hidroregjioni Jugor”- 95.8 %, KRU “Gjakova”- 87.7 % dhe KRU “Peja”-81.9 %. Pa mëdyshje, se në këto përqindje hynë edhe borxhet e viteve të më parme. Sidoqoftë, është përparim inkurajues i sektorit, në këtë zë rregullues.
11. Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetjake për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për 2023, janë realizuar për 53.11 %, nga të cilat, për shërbimet e ujit - 60.03 %, kurse për ujërat e ndotura -24 .05 %. Autoriteti, këto para të marra përmes tarifës nga konsumatorët, është duke kërkuar mënyrën më të përshtatshme, që t’i ekuivalentojë nëpërmjet procesit të ardhshëm tarifor.
12. Shumat e investimeve kapitale të realizuara nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për vitit 2023, janë realizuar për vetëm 29.56 %. Ndërkaq, për ujë - 35.10 %, kurse për ujëra të ndotura - 28.21 %.
13. Përfundimisht, përmbushja e caqeve të përcaktuara nga Autoriteti, ku merren për bazë humbjet e ujit, prodhimi, dhe investimet kapitale, veçanërisht ato në ujërat e ndotura, duket si në vijim:

- KRU "Hidromorava"- 88.10 %;
- KRU "Bifurkacioni" - 82.04 %;
- KRU "Gjakova"- 80.77 %;
- KRU "Hidrodrini"- 79.51 %;
- KRU "Mitrovica"- 77.4 %;
- KRU "Hidroregjioni Jugor"-76.6 % dhe
- KRU "Prishtina" - 75.77 %.

14. Shpenzimet operuese janë të ndryshme dhe kërkohet më shumë analiza për t'i harmonizuar me nevojat reale të operimit.

16. Ofruesit e shërbimeve nuk i kanë të ndara saktë të hyrat nga aktivitetet e vitit aktual nga ato të viteve të më parme. Kjo vështirëson fotografinë reale të sektorit në arkëtim.

17. Duhet që ofruesit e shërbimeve të monitorohen nga më afër, në mënyrë që besueshmëria e të dhënave të jetë më e kënaqshme.

20. Mbajtja e tryezave dhe e punëtorive, në funksion të përmirësimit të gjendjes, është imperativ i kohës.

21. Vizitat studimore të stafit të Autoritetit, për të jetësuar praktika të suksesshme, do të ishte dobiprurëse për sektorin. Falë këtyre vizitave, Departamenti i Tarifave, këtë vit prodhon më shumë analiza dhe e ka ngritur nivelin e kualitetit të tarifave.

## **PERSONAT KONTAKTUES PËR INFORMACIONE SHITESË RRETH RAPORTIT:**

Refik Ramaj – Drejtor i Departamentit të Tarifave (Refik.ramaj@arru-rks.org)

Hysni Feka – Analist për tarifa dhe financa rregullatorë (hysni.feka@arru-rks.org)

Vehbi Duraku – Analist i Investimeve Kapitale (vehbi.duraku@arru-rks.org)

---

**AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT**

Rr. Ali Pashë Tepelena, nr.01

Prishtinë, KOSOVË

Tel.:+ 383 38 24 91 65

<http://www.arru-rks.org>